

"SEL-TECH-MANAGEMENT " SH P K

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" SEL- TECH-MANAGEMENT " SH P K

1. KRIJIMI FORMA EMERTIMI SELIA KOHEZGJATJA DHE

OBJEKTI 1 SHOQERISE

1. TITULLI

Neni 1.1 - Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja dhe selia .

Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit

Sot, më 16 Nentor 2021 (dymijë e njezet e nje), në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Ne , themeluese , krijojmë, një Shoqëri Tregtare me emërtimin "SEL-TECH-MANAGEMENTI" SH.P.K , si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të së Drejtes Shqiptare , si me poshte vijon :

Adresa ..Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt ..00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 1



"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

Neni 1.2 Ortakë e shoqërisë:

Z Antonios Antoniadis, shtetas Grek, me dokument identifikimi te shtetit Grek me numer A H 894019, i biri i Iakovos, lindur me 25/09/2001 në Kavalla, Greqi, banues në Theagenus Charisi nr 88, Selanik 54453.Greqi.

Z Denis Ormënaj, shtetas Shqiptar, me dokument identifikimi shqiptar nr ID, K20125002S, i biri i Syrjaif, lindur me 25/01/2002, në Kucove, Shqiperi, banues në Rruga "Hamdi Sina" Tiranë.

Neni 2 Emertimi

2.1. Emertimi tregtar i shoqërisë është "SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

2.2. "SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Aktiviteti i kësaj shoqërie rregullohet nga ky statut dhe nga Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 3 Selia

3.1. Selia e shoqërisë është në qytetin e Korçës në adresën: Rruga "Partizani" ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korçe, Shqiperi.

3.2. Ajo mund të hapë degë dhe / ose filiale në të gjitha rrethet Brenda vendit si edhe jashtë tij, në bazë të legjislativëve përkatës.

Adresa ..Rruga "Partizani" ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korçe.....

Nr kontakt ..00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 2

"SEL-TECH-MANAGEMENT " SH P K

Neni 4 Vula

4.1 .Shoqeria ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj tregtar.

Neni 5 Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatje e shoqerise eshte e pacaktuar.

Neni 6 Objekti

6.1. Shoqeria ka per Objekt te veprimtarise se saj

1. Shitje te programeve kompjuterike te specializuata dhe asistence te tyre , per menaxhim te organizimit dhe funksionimit te veprimtarise se Njesive dhe Institucioneve Shteterore dhe te Pushtetit Lokal , te Institucioneve te Mesindhenies private dhe shteterore te te gjitha niveleve , te Shoqerive Private Tregtare , te OJF , dhe me tej te kesaj natyre ,, brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise .
2. Marrjen e cdo lloj leje te nevojshme dhe te leshuar nga organet kompetente, per studimin, kerkimin, shfrytezimin, perdorimin apo kryerjen e cdo dhe te gjitha veprimtarive te lejuara nga ligjet ne fuqi, ne lidhje me krijimet , menaxhimet , dhe mirembajtjet e programeve kompjuterike ne te gjitha fushat .
3. Kryerjen e cdo lloj aktiviteti , publikime dhe reklamime ne te gjitha mediat elektronike .
4. Blerje dhe shitje te paisjeve per llogari dhe ne funksion te aktivitetitj , brenda dhe jashte vendit .
5. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti te ligjshem , ne perputhje me objektin e aktivitetit dhe per te favorizuar ate..

Adresa ..Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 3



"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

6. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nenligjore të duhura. Ajo zbaton standartet me të larta të etikës.

2. ORTAKET KAPITALI THEMELTAR KONTRIBUTET PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Neni 7 Ortaket

7.1. Ortaket Themelues të shoqërisë "SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K, janë:

- Z Antonios Antoniadis, Shtetas Greq me kartë identifikimi të shtetit Greq A H 894019.
- Z Denis Ormënaj, Shtetas Shqiptar me kartë identifikimi të shtetit Shqiptar, K20125002S.

Neni 8

Kapitali i Rregjistruar

8.1. Vlera e Kapitalit të rregjistruar është 100.000 (njëqind mijë) Leke. Kapitali ndahet në 2 kuota të batabarta, të nënshkruara si më poshtë:

1. Z Antonios Antoniadis me 70 % të kuotave, pra me 1 kuota me vlerë totale 70 000 Lek.
2. Z Denis Ormënaj me 30 % të kuotave, pra me 1 kuota me vlerë totale 30 000 Lek.

Adresa "Rruga" Partizani " ND 80, H.8, Ap 17 7003 Korçe.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 4



"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

2. Z Denis Ormënaj me 30 % te kuotave , pra me 1 kuote me vlere totale 30 000 Lck .

8.2. Pjeset nuk materializohen ne letra me vlere te tregueshme por vertetohen me ane te çertifikatave nominative te lëshuara nga shoqëria.

8.3. Cdo kuote e kapitalit themelitar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.

8.4. Ortaket e shoqërise perballojne huambjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre te dardhur ne formimin e kapitalit themelitar.

Neni 9

Transferimi

9.1. Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve .

9.2. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek persona te trete dhe / ose transferimi i pjeseve ne rruge trashegimie, si dhe transferimi tek persona te trete qe nuk bejne pjese ne shoqëri in nenshtrohet ketyre rregullave:

a. Transferuesi apo trashëguesi ne rastin e transferimit ne rruge trashegimie, duhet t'i njoftoje shoqërise numrin e pjeseve qe do te transferohen, çmimin e shitjes ne rast shitjeje, si dhe emrin, mbiemrin dhe adresen e personit te cilit i transferohen pjeset.

Adresa "Rruga " Partizani " .ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 5



"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

b. Transferimi duhet të miratohet nga Asambleja e ortakëve brenda tre muajve nga dita e njoftimit. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda afatit tre mujor, miratimi qubet i dhene.

c. Asambleja miraton transferimin vetëm me shumicën e ortakëve të pranishëm që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave

d. Në rast se shoqëria refuzon transferimin; brenda tre muajve nga data e refuzimit, ortakët duhet t'i blejnë pjesët e propozuara për transferim. Çmimi i shitjes është vlera kontabel e pjesëve (book value). Nëse disa ortakë janë të interesuar njëherësh në blerjen e pjesëve, e drejta e tyre është proporcionale me numrin e pjesëve që ata zotërojnë. Në rast se asnjë ortak nuk është i interesuar të blejë pjesët, atëherë Asambleja duhet të vendosë, me shumicën e ortakëve të pranishëm që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave, nëse: 1. pjesët do t'i shiten personit të propozuar nga transferuesi me çmimin e rënë dakort midis tyre; 2. pjesët do t'i shiten një personi tjetër të tretë me çmimin e rënë dakort me këtë person por jo me pak se vlera kontabel e tyre.

9.3. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar, në çdo rast, duhet të vertetohet me akt noterial.

Neni 10

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

10.1. Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendim të vlefshëm për zmadhimin e kapitalit themeltar vetëm kur marrin pjesë ortakët me të drejtë voto që zotërojnë me shumicë së $\frac{1}{2}$ e numrit total të votave.

Adresa ..Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korçë.....

Nr kontakt ..00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 6

"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

Kapitali themeltar zmadhohet me vendim te ortakëve te pranishern qe perfaqesojne te pakten $3/4$ (tre te katerrat) e votave.

10.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.

10.3. Ortaketkane te drejten e nrijes ne menyte proporcionale (ne te njejten mase me pjeset e kapitalit qe ata perfaqesojne). Askush nuk mund te favorizohet apo te disfavitizohet nepermjet zmadhimit te kapitalit (parimi i trajtimit te barabarte).

10.4 . Megjithate, ne asnje rast, ortakët qe perfaqesojne shumicen e cilesuar sipas pikës 11.8. te nenit 11 dhe pikës 9.1. te nenit 9 te ketij statuti, nuk mund te detyrojne nje apo disa ortakë te minorances per te rritur angazhimin e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise. Ne kete rast, kapitali rritet ne menyte proporcionale ndetmjet ortakëve qe kane pranuar zmadhimin e tij.

10.5. Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve ne para, te gjitha pjeset e reja duhet te nenshkruhen dhe shlyhen teresisht. Ato duhet te deponohen nga nenshkruesi per llogari te shoqerise. Terheqja e fondeve te reja mund te behet vetem pas regjistrimit te zmadhimit te kapitalit ne Regjistrin Tregtar.

Neni 11

Zvoglimi i Kapitali Themeltar

Adresa "Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korçe.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 7



"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

11.1. Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim te vlefshem per zvogelimin e kapitalit themeltar vetem kur marren pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se $1/2$ e numrit total te votave.

Kapitali themeltar zmadhohet me vendim te ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten $3/4$ (tre te katertat) e votave.

11.2. Zvoglimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata perfaqesojne.

11.3. Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te konsistuar ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, brenda tre muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, ortaket qe perfaqesojne shumicen e cilesuar sipas pikes 11.8. te nenit 11 dhe pikes 10.1. te nenit 10 te ketyj statuti, duhet te vendosin ose prishjen e shoqerise, ose zvogelimin e kapitalit me nje vlerë me te madhe se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat, por pa e zbritur kapitalin nen shumen minimale, ne perputhje me nenin 70 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

3. MARRJA E VENDIMEVE ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 12

Asambleja e Ortakeve

12.1. Vendimet merren nga asambleja e ortakeve.

Adresa "Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 8

"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH.P.K

12.2. Çdo ortak ka të drejte të marre pjesë në mbledhjet dhe në vendimet e asamblese dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesën e kapitalit themeluar që ai zoteron. Çdo ortak ka të drejte të përfaqesohet në këto mbledhje nga një ortak tjetër. Ose nga një mandatbajtës i cili mund të votojë në emër të atij që përfaqeson.

12.3. Asambleja mbledhet në mënyrë të rregullt dhe mund të thirret në çdo kohë sipas parashikimeve të nenëve 82, 83 dhe 84 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

12.4. Asambleja thirret nga Kryetari i Asamblese ose në mungesë të tij, nga Administratori. Kryetari i Asamblese emrohet dhe ndryshohet nga Asambleja me shumicë të thjeshtë. Ai nuk është përfshirë në shoqëri.

12.5. Kryetari i asamblese emron një person fizik, ortak ose jo, në pozitën e sekretarit. Sekretari mban proces - verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga të gjithë ortakët e pranishëm në mbledhje.

12.6. Votimi është në parim i hapur. Me kërkesë të një ose disa ortakëve të pranishëm që përfaqesojnë më shumë se gjysmën e votave, votimi është sekret.

12.7. Janë në kompetencën e Asamblese dhe nuk mund t'i delegohen Administratorit, marrja e vendimeve për sa i përket:

- a. ndryshimi i statutit
- b. riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi, shndërrimi
- c. zmadhimi, zvoglimi i kapitalit

Adresa "Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64
927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 9

"SEL-TECH-MANAGEMENT " SH P K

- d. miratimi i llogarive, raporti vjetor, inventaret, raporti i eksperteve kontabel te autorizuar
- e. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese
- f. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit
- g. emerimi dhe shkarkimi i Eksperteve Kontabel te Autorizuar
- h. re gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe / ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese.

12.8 Asambleja merr vendim me :

- a. shumice te thjeshte: me shume se $1/2$ e votave te ortakeve pjesemarres, ose
- b. shumice te cilesuar: me $3/4$ e votave te ortakeve pjesemarres sipas parashikimit te nenit 87 te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtate".

12.9 Asambleja vendos me shumice te cilesuar ne lidhje me .

- a. ndryshimin e statutit
- b. transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek nje i trete
- c. zmadhimin apo zvoglimin e kapitalit themeltar
- d. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- e. shperndarjen e fitimeve

12.10 . Per cdo ceshtje tjeter, Asambleja vendos me shumice te thjeshte.

Adresa „Rruga “ Partizani “ ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korice.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 10



"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

12.11. Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te veçante, qe mbalhet ne seline e shoqerise.

Neni 13

Administrimi

13.1. Shoqeria administrohet nga Administratori, emerimi i te cilit behet sipas rregullave te Ligjit No.9901, pjesa qe ben fiale per sh.p.k.-te. Administratori i pare i shoqerise eshte Z.Iakovos Antoniadis , shtetas Grek , me karte identifikimi teleshuar nga shteti Grek me nr A I 890313 dhe mandati i tij si Administrator eshte 5 vjet.

13.2 Administratori/et kane pergjegjesi individuale ndaj shoqerise apo te atreve per shkelje ligjore, per shkelje te statutit apo per faje gjate administrimit te shoqerise.

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

14.1. Marrredheniet midis administratorit/ve, kompetencat, te drejta dhe detyrimet e tyre rregullohen nga Akti i Emerimit dhe Statuti.

14.2. Administratori/et ka keto kompetenca dhe detyra:

- Te monitoroje dhe te supervizoje zbatimin e politikave te biznesit;

Adresa „Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 11

"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

- Me kerkese te Asamblesë së Ortakeve të marre të gjitha masat në kompetencë të tij dhe të zbatojë zbatime ato;
- Të sigurojë që Shoqëria zbaton ligjet e aplikueshme për të dhe standartet e duhura të kontabilitetit;
- Të ekzaminojë dhe të mbajë Librat e Shoqërisë, dokumentat dhe ascret;
- Të sigurojë që librat e auditit dhe të dhenat të tjera të kontrollohen në paktën një herë në vit nga eksperti kontabel i autorizuar;
- Me kerkese të Asamblesë së Ortakeve të marre të gjitha masat në kompetencë të tij dhe të zbatojë zbatime ato;

Neni 15

Eksperti Kontabel i Autorizuar .

15.1. Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar (person fizik apo shoqëri).

15.2. Eksperti Kontabel caktohet me vendim të Asamblesë, me shumicë të thjeshtë.

4. VITI FINANCIAR , LLOGARITE E BILANCIT VJETOR , NDARJA E FITIMIT

Neni 16

Viti financiar

16.1 Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor.

Adresa "Rruga "Partizani" "ND 80 ,H.8 ,Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Piici)

.....Page 12



"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

Perjashtimisht ben viti i pare i krijimit te shoqerise i cili fillon ne diren e rregjistrimit dhe perfundon ne 31 Dhjetor te vitit aktual .

Neni 17

Llogarite vjetore

17.1. Llogarite vjetore, inventari, raporte mbi operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e veçuara te hartuara nga Administratori dhe eventualisht nga Eksperti Kontabel i Autorizuar, mifatohen nga Asambleja e Pergjithshme.

17. 2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

Neni 18

Fitimi

18.1. Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjrha shpenzimet, si edhe fondet e lena reserve per rritje ekonomike, per investime per reklame tregtare etj, ndahen ndermjet ortakëve ne perputhje me pergjindjen e kapitali themeltar qe ka secili ortak.

18.2. Ortaku i huaj, fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqerise, sipas pergjindjes qe i takon, mund te transferoje jashte shtetit, ne perputhje me dispozitat ligjore shqiptare ne fuqi.

Neni 19

Bilanci

Adresa ..Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt ..00355 67 68 64
927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 13

"SEL-TECH-MANAGEMENT" SH P K

19.1. Bilanci vjetor i shoqerise mbyllet brenda 31 Marsit te vitit pasardhes .

5. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI

Neni 20 Likuidimi

20.1. Shoqeria priset me vendim te Asamblese me shumice te cilesuar dhe ne perputhje me ligjet ne Republiken e Shqiperise.

20.2. Ne rastin e prishjes se shoqerise , ajo kryen procesin e likuidimit ne perputhje me ligjet ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

6 . DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 21 Mosmarreshjet

21.1. Per te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce .

Me daten 16 Nentor 2021, ne Korce, u hartua dhe u nenshkrua, me vullnetin e lire te Ortakeve Themelues, **Z Antonios Antoniadis** dhe **Z Denis Ormënaj**,

Adresa ..Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 14



"SEL-TECH-MANAGEMENT " SH P K

Akt-Themelimi dhe Statut i Shoqerise " SEL-TECH-MANAGEMENT
" SH P K , ne 5 kopje ne gjuhen shqipe, me vlete te njejte ligjore.

NJOH GJUHEN
SHQIPE ORTAKET THEMELUES
Antonios Antoniadis

Antonios
Antoniadis
A

Denis Ormënaj,
Denis ORMĒNAJ

Denis

Adresa „Rruga " Partizani " ..ND 80 ,H.8 , Ap 17 7003 Korce.....

Nr kontakt .00355 67 68 64

927.....

Personi i kontaktit : Anila Lubonja (Prici)

.....Page 15